



PK. SH.A.
Posta e Kosovës SH.A.
Post of Kosovo J.S.C.
Pošta Kosova D.D.

nr./No./Br. 01-1259/26
Data/Date/Datum 08-07-26
PRISHINE-PRISTINA-PRISTINA

Në bazë të nenit 8 të Ligjit për Punësim (Ligji nr. 03/L-212), Rregullores për rregullimin e marrëdhënieve të punës nr. 01-3060/24, datë 31.12.2024, si dhe Vendimit të Bordit Drejtues nr. 01-1020/26, datë 29.05.2026, PK Sh.A. më datë 08.07.2026 shpall:

KONKURS PUBLIK PËR VENDE PUNE

Titulli i pozitës: **Postier (grada 4) 3 ekzekutues**

Numri i referencës: 07/26

Përshkrimi: PK Sh.A. është duke bërë përpjekje për të zhvilluar biznesin në përputhje me përvojat më moderne të shërbimeve postare dhe komerciale, në mënyrë që të arrihen standardet ndërkombëtare në ofrimin e shërbimeve postare dhe komerciale. Në këtë kontekst, PK Sh.A. ofron mundësi të barabarta punësimi për profesionistët që synojnë të jenë pjesë e zhvillimit të biznesit dhe kompetencave të ndërmarrjes në përputhje me metodat dhe praktikat moderne.

Kohëzgjatja e kontratës: Në përputhje me nenin 21 pika 9, nenet 23 dhe 24 të Rregullores për rregullimin e marrëdhënieve të punës për të punësuarit në Postën e Kosovës nr. 01-3060/24 datë 31.12.2024, kontrata e punës është për kohë të pacaktuar, në të cilën periudhë përfshihet edhe periudha provuese prej 6 muajsh.

Pozita e punës: Postier/e

Regjioni i Gjakovës

1 (një) ekzekutues në Rogovë

Regjioni i Ferizajt

1 (një) ekzekutues në Han të Elezit

Regjioni i Mitrovicës

1 (një) ekzekutues në Leposaviq.

Detyrat dhe përgjegjësitë kryesore:

Pranon dhe shpërndan letërdërgesat, kolipostat, apo produktet tjera që i ofron PK Sh.A. të ndara/ngarkuara nga kartuesi/ja. Është përgjegjës/e për pranimin, dorëzimin e letërdërgesave, kolipostave në rajonin përkatës. Bën shitjes e produkteve sipas shërbimeve që ofrohen nga PK Sh.A. dhe është përgjegjës/e për arritjen e targeteve të caktuara nga Qendra për shitjen e produkteve. Mban përgjegjësi për produktet e pranuar për shitje, tel. USSD, evidencë, klasifikim dhe ruajtje të dokumentacionit manipulativ në baza ditore, dekadore dhe mujore. Zbaton ndryshimet e paraqitura në lidhje me shpërndarjen dhe dorëzimin. Është përgjegjës/e për mirësjellje, zbatimin e Kodit të Mirësjelljes dhe Kodit mbi Trajtimin e Dërgesave Postare. Kryen edhe punë tjera të nevojshme të parashtruara nga Kontrollori i Shpërndarjes/Kartuesi apo Përgjegjësi i Zyrës Postare.

Për punën e vet i përgjigjet Kontrollorit të Shpërndarjes/Përgjegjësit të Zyrës Postare.

Kualifikimi dhe përvoja e nevojshme:

- Punonjësi/punonjësja, për ushtrimin e detyrave dhe përgjegjësive të Postierit/es duhet të ketë kualifikim të mesëm shkollor, preferohet në drejtimin e shërbimit postar.
- Aftësi të mira organizative dhe komunikuese.
- Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës.

Dokumentacioni i kërkuar

Kandidati/ja duhet t'i dorëzojë këto dokumente:

1. Aplikacionin për punësim (shkarkohet nga ueb faqja e Postës së Kosovës https://postakosoves.com/publikime/mundesi_punesimi/).
2. Diplomën mbi shkollimin (diploma e fituar jashtë Republikës së Kosovës duhet të jetë e nostrifikuar sipas ligjit).
3. CV-në.
4. Kopjen e letërnjoftimit apo pasaportës valide.
5. Dëshminë nga gjykata kompetente që ndaj kandidatit në fjalë nuk është duke u zhvilluar procedurë penale, jo më e vjetër se 6 muaj.

Mënyra e aplikimit:

Aplikacionet mund të merren online në www.postakosoves.com dhe së bashku me dëshmitë përkatëse të dërgohen nëpërmjet postës në adresën: Arkivi i PK Sh.A. - Ndërtesa kryesore e PK-së, Rr. "28 Nëntori" nr. 4, 10000 Prishtinë, deri në afatin e parapare për aplikim me shenjën "PËR KONKURS", duke e cekur titullin e vendit të punës dhe regjionin për të cilin aplikoni.

Aplikacioni dhe të gjitha dëshmitë bashkëngjiten të fotokopjuara, sepse të njëjtat nuk iu kthehen aplikantëve.

- Aplikacionet e pakompletuara nuk do të merren parasysh.
- Aplikacionet, të cilat dorëzohen pas afatit nuk do të shqyrtohen.
- Çdo përgënjeshtim i materialit, qoftë i qëllimshëm ose nga neglizhenca, ose ndryshim material nga informatat e dhëna në deklaratën e sipër cekur do të rezultojë në skualifikimin e menjëhershëm.

Vërejtje:

Dokumentacioni i dërguar për këtë konkurs duhet të jetë kopje (përveç certifikatës nën hetime të lëshuar nga Gjykata që me rastin e intervistës duhet të sillet origjinali), sepse të njëjtat nuk iu kthehen kandidatëve.

Informata të përgjithshme:


Të drejtë aplikimi për këtë konkurs kanë të gjithë qytetarët pa dallim.

Ndërmarrja ofron mundësi të barabarta, inkurajon dhe promovon angazhimin e punëtorëve, pjesëtarë të të gjitha komuniteteve dhe të gjinive të ndryshme.

Konkursi është i hapur nga data 08.07.2026 dhe përfundon më datë 15.07.2026 në ora 24:00.

Kandidatët që i plotësojnë kushtet, fillimisht do t'iu nënshtrohen testit me shkrim dhe vetëm ata kandidatë, të cilët do të kalojnë testin do të hyjnë në rrethin e ngushtë dhe do t'iu nënshtrohen intervistës.

Nora Rraci


Kryeshefe Ekzekutive e PK Sh.A.

